


REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E DREJTËSISË

MANUAL

SI TË PËRFITOHMË NDIHMË JURIDIKE FALAS

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
2020



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E DREJTËSISË

MANUAL

SI TË PËRFITOHJË NDIHMË JURIDIKE FALAS

2020



TABELA E PËRMBAJTJES

Çfarë është ndihma juridike falas?	5
Kush përfiton nga ky shërbim?	5
Çfarë shërbimesh ofrohen?	7
Kujt mund t'i drejtoheni për të përfituar nga ky shërbim?	9
Cila është procedura që duhet të ndiqni?	11
Si mund të na kontaktoni?	13

1 ÇFARË ËSHTË NDIHMA JURIDIKE FALAS ?

“Ndhim juridike” është shërbimi juridik falas i cili garantohet dhe financohet nga shteti për të gjithë individët, pjesë e kategorive vulnerabël dhe/ose metë ardhura të pamjaftueshme të cilët nuk kanë mundësi t`i drejtohen një juristi apo avokati për të zgjidhur problematikën e tyre ligjore.

Është mision dhe detyrë e shtetit të mundësojë aksesin në drejtësi (të drejtën për të përfituar shërbim ligjor falas për këta individë) duke mbrojtur të drejtat e tyre themelore Kushtetuese.

Me qëllim përmbushjen e këtij misioni, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 111/2017, **Ministria e Drejtësisë** ka ndryshuar strukturën e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti duke krijuar tashmë një institucion të veçantë, të dedikuar për këtë qëllim. Ky institucion, **Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas**, në bashkëpunim me institucione të tjera shtetërore/partnerë privatë (kombëtarë dhe ndërkombëtarë), mundëson ofrimin e ndihmës juridike përmes juristëve/avokatëve falas për individët të cilët nuk e përballojnë dot pagesën e një jursti/avokati.

2 KUSH PËRFITON NGA KY SHËRBIM ?

Nga ky shërbim përfitojnë shtetasit në kushtet e pamundësisë ekonomike (metë ardhura dhe pasuritë pamjaftueshme) si dhe kategoritë vulnerabël, të përcaktuara si vijon:

Pamundësia ekonomike

Ngakushërbimpërfitojnë të gjithë ata shtetas të cilët janë në kushtet e pamundësisë ekonomike, dhe kanë nevojë për një shërbim ligjor (këshillim/orientim ligjor apo përfaqësim në gjykatë).

Që shtetasit të jenë përfitues **për shkak të pamundësisë së tyre ekonomike**, ligji ka përcaktuar disa kritere, dhe konkretisht:

“Të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuar për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50 për qind e pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi”

Referuar legjislacionit në fuqi, aktualisht paga minimale mujore në Republikën e Shqipërisë është 26 mijë lekë të reja.

Bazuar në këtë kriter, për shembull nëse familja juaj përbëhet prej 4 personash, dhe të ardhurat totale të familjes pjestim për numrin e anëtarëve të familjes (4) janë më të ulëta se 130 mijë lekë të vjetra në muaj, ju mund të përfitoni nga shërbimet ligjore falas.

“Të ardhurat e një personi, i cili nuk jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi”

Referuar këtij kriteri, nëse personi që kërkon shërbim ligjor falas nuk jeton me familjen e tij/saj do të jetë përfitues nëse të ardhurat e tij janë më të ulëta se 26 mijë lekë në muaj.

“Nëse një person, i cili jeton në një familje, kërkon ndihmë juridike dytësore për një çështje kundër një anëtari tjetër të së njëjtës familje të ardhurat e këtij personi konsiderohen të pamjaftueshme, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi”

Nëse personi që kërkon shërbim ligjor falas (avokat falas për përfaqësim në gjykatë), jeton me familjen dhe problematikën e ka kundër një anëtari tjetër të familjes së tij, në këtë rast nuk do aplikohet kriteri i parë por ai/ajo do të jetë përfitues nëse të ardhurat e tij janë më të ulëta se 26 mijë lekë në muaj.

** Gjithashtu, përveç kriteve të mësipërme, personi nuk duhet të ketë në emër të tij pasuri (të luajtshme/ të paluajtshme përveç banesës së përbashkët familjare e cila nuk përfshihet), që tejkalojnë vlerën e 36 pagave minimale mujore sipas legjislacionit në fuqi (Afërsisht 940.000 lekë).

Përveç kriterit bazë (pamundësisë ekonomike), ligji ka parashikuar dhe një kategori të veçantë të cilët përfitojnë nga shërbimet ligjore falas pavarësisht nëse e përmbushin apo jo kriterin e pamundësisë ekonomike.

Kategoritë vulnerabël (përfitues në mënyrë të drejtëpërdrejtë)

Që shtetasit të jenë përfitues **në mënyrë të drejtëpërdrejtë, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre** ligji ka përcaktuar disa kritere. Individit në këtë rast, mjafton të vërtetojë që bën pjesë në një prej këtyre kategorive:

- Viktimë e dhunës në familje;
- Viktimë e abuzimit seksual;
- Viktimë e trafikimit të qënieve njerëzore;
- Viktimë emitur;
- I mitur në konflikt me ligjin;
- Fëmijë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- Fëmijë nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisnin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- Person me aftësi të kufizuar dhe të verbërit;
- Person me problem të shëndetit mendor;
- Person, përfitues i skemave të mbrojtjes sociale;
- Person, të cilin i është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent.

ÇFARË SHËRBIMESH OFROHEN?

Ligji për ndihmën juridike parashikon tre forma/lloje ndihme ligjore për qytetarët:

- Ndihmë juridike parësore;
- Ndihmë juridike dytësore;
- Përrjashtim nga taksat dhe tarifatat gjyqësore

Forma e parë e ndihmës ligjore apo ndryshe (Ndihma Juridike Parësore),

është ai lloj shërbimi ligjor i cili konsiston në:

- dhënien e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;
- dhënien e këshillimit;

- dhënien e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;
- dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;
- përfaqësimin përpara organeve administrative; dhe
- dhënien e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Forma e dytë e ndihmës ligjore apo ndryshe (Ndihma Juridike Dytësore),

është ai lloj shërbimi ligjor që ofrohet për problematikat zgjidhja e të cilave mund të realizohet vetëm nëpërmjet gjykatës **apo prokurorisë**. Kjo lloj ndihme ofrohet nga avokatët e licencuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Personi me anë të avokatit falas i drejtohet gjykatës apo prokurorisë për zgjidhjen e çështjeve apo problematikave të çdo fushe (civile, penale, administrative).

Gjithashtu, personat që mund të përfitojnë nga kjo formë e **ndihmës juridike mund të përfitojnë përjashtim nga:**

- **Pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore** (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit);
- **Parapagimi i tarifës së ekzekutimit të vendimit** pranë shërbimit përbarimor gjyqësor shtetëror.

SHËNIM

Për të përfituar nga përjashtimi për pagimin e tarifave të përmendura më lart ju mund të kërkonit ndihmën e avokatit falas të caktuar i cili do t'ju orientojë në plotësimin e formularit të kërkesës për përjashtimin nga pagimi i tarifave/ shpenzimeve gjyqësore.

4 KUJT MUND T'I DREJTOHENI PËR TË PËRFITUAR NGA KY SHËRBIM?

Për të përfituar nga ndihmë juridike PARËSORE ju mund të drejtoheni pranë:

- ▶ QENDRAVE TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE janë zyra të ngritura me qëllim ofrimin e këshillimit dhe dhënien e orientimeve ligjore falas.
- ▶ KLINIKAVE E LIGJIT PRANË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË janë zyra të ngritura pranë fakulteteve me qëllim ofrimin e këshillimit dhe dhënien e orientimeve ligjore falas.
- ▶ ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE TË AUTORIZUARA (janë organizatat të cilat ofrojnë shërbim ligjor falas, pas marrjes së autorizimit nga Ministri i Drejtësisë për ofrimin e këtij shërbimi)

SHËNIM:

Për t' u informuar mbi vendndodhjen dhe kontaktet e punonjësve të qendrave, klinikave dhe organizatave jofitimprurëse të cilat janë të hapura në pjesën më të madhe të Republikës së Shqipërisë mund të na kontaktoni në:



Faqen zyrtare web të Drejtorisë së Ndhmës Juridike falas:
www.ndihmajuridike.gov.al

Numri jeshil pa pagesë:
08001010

Facebook:
Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas

Instagram:
Drejtoriandihmësjuridikefalas

Ndihma juridike parësore mund të përfitohet edhe ONLINE:

 Në platformën www.juristionline.al

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka vijuar me ofrimin e shërbimeve ligjore **online** përmes platformës juristionline.al.

Përmes kësaj platforme çdo qytetar ka mundësi të këshillohet dhe mbi aktet ligjore në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e tyre; dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.

 Përmes numrit të telefonit falas **08001010**

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë ka vendosur në dispozicion një linjë të gjelbër në të cilën do të kenë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndihmës juridike. Vendosja e një numri falas është një garanci më shumë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për qytetarët disponibilitet në çdo kohë dhe përmes disa formave. Si platforma [juristionline](http://juristionline.al) ashtu edhe linja e gjelbër janë masa të shtuara duke garantuar shërbime sa më pranë qytetarit.

Përtë përfituar nga ndihma juridike DYTËSORE (përfaqësim me avokat falas në gjykatë/prokurori) ju mund t`i drejtoheni:

- ▶ GJYKATAVE
(civile/penale/administrative)
- ▶ PROKURORIVE
(pranë vendqëndrimit tuaj)

5 CILA ËSHTË PROCEDURA QË DUHET TË NDIQNI?

Përtëpërfituar ndihmë juridike parësore (orientim/këshillim ligjor), ju mund të drejtoheni personalisht apo me anë të shërbimit postar, pranë qendrave, klinikave apo organizatave jofitimprurëse të autorizuara ku juristët, nëse plotësoni kriteret e përcaktuara nga ligji, do t'ju ndihmojnë në plotësimin e:

- Formularit të kërkesës dhe vetëdeklarimit për ndihmë juridike parësore;
- Formularin e vetëdeklarimit për të ardhurat dhe pasuritë;
- Formularin e vetëdeklarimit për kategoritë e veçanta vulnerabël (nëse përfshiheni në këtë kategori).

SHËNIM:

Këta formularë mund t'i gjeni në çdo kohë elektronikisht në faqen zyrtare të:

 Ministrisë së Drejtësisë www.drejtesia.gov.al

 Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas www.ndihmajuridike.gov.al

Ky formular, [duhet të shoqërohet edhe nga disa dokumenta vërtetues të llojit:](#)

- Çertifikatë familjare, dhe në varësi të rastit;
- Vërtetim papunësie;
- Vërtetim që trajtohesh me ndihmë ekonomike;
- Vërtetim që trajtohesh me kemp (paaftësi mendore/fizike);
- Vërtetim mbi pasuritë e paluajtshme që disponon;
- Vërtetim page bruto dhe neto;
- Vërtetim nga sigurimet shoqërore në rast të pagesës që kryhet prej këtyre institucioneve sikurse mund të jetë pensioni i pleqërisë.

Për të përfituar ndihmë juridike dytësore,
ju mund të drejtoheni personalisht ose me anë të shërbimit postar pranë:
Gjykatësoseprokurorisë, përpara apo në fillim të një procesi gjyqësor duke plotësuar:

- Formularin e kërkesës dhe vetëdeklarimit për ndihmë juridike dytësore;
- Formularin e vetëdeklarimit për të ardhurat dhe pasuritë;
- Formularin e vetëdeklarimit për kategoritë e veçanta (nëse përfshihen në këtë kategori).

SHËNIM

Nëse hasni vështirësi me plotësimin e këtij formulari, ju mund të kërkonin ndihmë pranë ofruesve të ndihmës juridike parësore (qendrave, klinikave ligjore, organizatave jofitimprurëse të autorizuar) të cituara më lart që ofrojnë këshillim dhe orientim ligjor dhe më pasta dërgoni këtë formular në gjykatë apo prokurori.

Gjthashtu, personi që gëzon të drejtën për të përfituar nga forma e dytë e ndihmës ligjore, mund ta paraqesë kërkesën nëpërmjet:

- Një përfaqësuesi ligjor apo të pajisur me prokurë, (akt noterial); ose
- Nëpërmjet bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es ose një të afërmi.

Ky formular, duhet të shoqërohet edhe nga disa dokumenta vërtetues të llojit:

- Çertifikatë familjare, dhe në varësi të rastit;
- Vërtetim papunësie;
- Vërtetim që trajtohet me ndihmë ekonomike;
- Vërtetim që trajtohet me kemp (pa aftësi mendore/fizike);
- Vërtetim mbi pasuritë e paluajtshme që disponon;
- Vërtetim page bruto dhe neto;
- Vërtetim nga sigurimet shoqërore në rast të pagesës që kryhet prej këtyre institucioneve sikurëse mund të jetë pensioni i pleqërisë.

Gjykata/Prokuroria shqyrton kërkesën për përfitimin e ndihmës ligjore dhe brenda 5 ditësh pas shqyrtimit të saj vendos:

- Pranimin e kërkesës;
- Rrëzimin e kërkesës

SHËNIM

Kundër vendimit për rrëzimin e kërkesës mund të bëhet ankim i veçantë sipas formularit tip të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, i cili i jepet kërkuarit së bashku me vendimin për rrëzimin e kërkesës.

Në rast të pranimit të kërkesës, përfituesit i vihet në dispozicion **një avokat**, i cili ka për detyrë të ndjekë të gjithë problematikën e tij, deri në zgjidhjen përfundimtare të saj.

SI MUND TË NA KONTAKTONI?

PRANË DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Për çdo pyetje/paqartësi mund të drejtoheni personalisht/ elektronikisht ose me anë të shërbimit postar pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas pranë Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu, për çdo ankesë tuajën mbi cilësinë e dhënies së shërbimit të ndihmës ligjore nga juristët dhe avokatët, mund të drejtoheni pranë Institucionit tonë:

 adresa: **Rr. e Barrikadave Rr. e Barrikadave, Ndërtesa nr. 18, Hyrja 6, kati 3, zyra 10**

 email: **dnjf@drejtesia.gov.al**

Në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

 **Facebook@DrejtoriaeNdhmësJuridikeFalas**

 **Instagram@drejtoriandhmesjuridikefalas**

Mos hezitoni të na kontaktoni !

the \mathbb{R}^n is a \mathbb{R}^n -valued function on \mathbb{R}^n . The function f is said to be *linear* if it satisfies the following conditions:

(1) $f(x + y) = f(x) + f(y)$ for all $x, y \in \mathbb{R}^n$.

(2) $f(ax) = af(x)$ for all $x \in \mathbb{R}^n$ and $a \in \mathbb{R}$.

It is easy to see that a linear function f is completely determined by its values on the standard basis e_1, \dots, e_n of \mathbb{R}^n .

Let f be a linear function. Then f can be represented as a matrix A of size $n \times n$ such that

$$f(x) = Ax \quad \text{for all } x \in \mathbb{R}^n.$$

Conversely, given a matrix A of size $n \times n$, the function $f(x) = Ax$ is a linear function.

Let f be a linear function. Then f is invertible if and only if the matrix A is invertible.

Let f be a linear function. Then f is surjective if and only if the matrix A is invertible.

Let f be a linear function. Then f is injective if and only if the matrix A is invertible.

Let f be a linear function. Then f is bijective if and only if the matrix A is invertible.

Let f be a linear function. Then f is a linear isomorphism if and only if the matrix A is invertible.

Let f be a linear function. Then f is a linear homeomorphism if and only if the matrix A is invertible.

Let f be a linear function. Then f is a linear diffeomorphism if and only if the matrix A is invertible.

Let f be a linear function. Then f is a linear automorphism if and only if the matrix A is invertible.

Let f be a linear function. Then f is a linear transformation if and only if the matrix A is invertible.

Let f be a linear function. Then f is a linear map if and only if the matrix A is invertible.